



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 480/9 prot.

Tiranë, më 22. 08. 2024

V E N D I M

Nr. 233, datë 22. 08. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 62 Regj., datë 28.03.2024³, të grupit të personave/mjekë specialistë epidemiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me pretendimin e diskriminimit nga VKM nr. 764, datë 28.12.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësine Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin përkatës”*, të ndryshuar, për shkak të gjendjes arsimore, përkatësisë në një grup të veçantë⁴ dhe çdo shkak tjetër⁵.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, të cilët bëjnë pjesë në grupin e mjekëve epidemiologë, të atashuar pranë NJVKSH-ve, në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, kanë parashtruar se:

“Ne jemi një grup mjekësh epidemiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Sipas VKM nr. 764, datë 28.12.2023, të gjithë mjekët specialistë janë trajtuar me një rritje page prej 50 000 lekësh për pozicionin e punës, me përjashtim të mjekëve epidemiologë, pranë NJVKSH-ve.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Plotësuar dhe saktësuar nga subjekti ankues nëpërmjet e-mailit datë 03.04.2024.

⁴ Si pjesë e grupimit të mjekëve specialistë epidemiologë, të atashuar pranë NJVKSH-ve.

⁵ Diskriminimi në lidhje me pagesën për të gjithë mjekët specialist Epidemiologë pranë NJVKSH-ve dhe në lidhje me emërtimin sipas kërkesës së pozicionit të punës për mjekët specialist Epidemiolog të NJVKSH-ve.

Bazuar në VKM-në sipërcituar, vihet re, që mjekët me specialitet afatgjatë për epidemiologji, të cilët janë emëruar nga Ministria e Shëndetësisë pranë NJVKSH-ve, nuk janë të specifikuar në asnjë nga strukturat dhe nivelet e pagave të parashikuara në këtë Vendim, sikundër është vepruar për rastet ku institucionet kanë në strukturë mjekë me specialitet dhe mjekë të përgjithshëm.

Mjeku epidemiolog i përket kategorisë së Mjekut Specialist, i cili ka kryer specializim afatgjatë pasuniversitar pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, në përfundim të të cilit është titulluar “Mjek Specialist Epidemiolog” dhe është pajisur me diplomë specializimi.

Sipas VKM-së sipërcituar, Mjekët Epidemiologë janë trajtuar në mënyrë të barabartë me Punonjësit Social, apo shkollimet e tjera të Mësuesisë, Veterinarisë, Psikologjisë apo Mjekët e Përgjithshëm brenda NJVKSH-ve.

Situata ku ndodhemi, na ka bërë të ndihemi të diskriminuar dhe të lënë në harresë, kur në fakt përbëjmë pikën kyçe për evidentimin e situatës epidemiologjike të sëmundjeve ngjitëse në vend, ndjekjen e të gjitha shpërthimeve epidemike dhe së fundmi edhe pandeminë e Covid-19, parandalimin e këtyre sëmundjeve.

Ne si mjekë specialistë epidemiologë kërkojmë të trajtohemi njësoj si mjekët e tjerë specialistë pranë NJVKSH-ve, pasi në gjykimin tonë jemi lënë në harresë dhe të diskriminuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj pranë Komisionerit subjekti ankues/grupi i personave, mjekë specialistë epidemiologë pranë NJVKSH-ve, ka kërkuar të konstatohet diskriminimi kundrejt këtij grupi të veçantë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të rishikohet VKM nr. 764, datë 28.12.2023, sa i takon kategorizimit të tyre, në grupin e mjekëve specialistë që përfitojnë një rritje page prej 50.000 lekësh për pozicionin e punës, duke u trajtuar në mënyrë të barabartë me ta.

Gjithashtu nga ana e mjekëve epidemiolog, është kërkuar nga Komisioneri që: “të merren masa për dëmshpërblimin sipas vlerës së mohuar nga paga që i ka takuar mjekut specialist më parë”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të bërë nga grupi i mjekëve epidemiologë, pranë NJVKSH-ve, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 480/2 prot., datë 09.04.2024, i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekteve ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale, përmes shkresës⁶ nr. 1759/1 prot., datë 22.04.2024, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e saj sa i përket ankesës së paraqitur nga subjektet ankues, duke sqaruar ndër të tjera se: *“Bazuar në politikat e qeverisë, reforma për rritjen e pagave për punonjësit e administratës publike është shtrirë në dy vite dhe përfshin vitet 2023-2024.*

Me Urdhrin nr. 677, datë 13.11.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e sistemit të pagave në sistemin shëndetësor”, është ngritur një grup pune, i cili do të rishikojë legjislacionin në fuqi, që autorizon miratimin e strukturës së pagave për punonjësit e shëndetësisë dhe do të paraqesë propozimet e nevojshme për ndryshim.

Objekt i vlerësimit të Grupit të Punës do të jetë dhe ankesa e mjekëve të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor”.

2. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 05.06.2024, i përcolli subjekteve ankues parashtrimet e MSHMS-së.

Në përgjigje të këtij e-maili, subjektet ankues nuk vunë në dispozicion asnjë informacion shtesë.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 480/3 prot., datë 24.04.2024.

3. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 480/4 prot., datë 13.06.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 04.07.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi që gjatë seancës të depozitohet kopje e dokumentacionit, si më poshtë:
- *Parashtrime sa i përket hapave të ndërmarrë nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin nr. 677, datë 13.11.2023. A ka ndonjë propozim aktual nga Grupi i Punës lidhur me kërkesat e mjekëve të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor? Nëse po, të vihet në dispozicion të Komisionerit informacioni i kërkuar mësipër”.*
4. Seanca dëgjimore u realizua me praninë e përfaqësuesve të subjekteve ankues, dhe në mungesë të përfaqësuesve të institucioneve të ftuara në seancë: Këshillit të Ministrave, dhe MSHMS-së.

Gjatë seancës përfaqësuesit e subjekteve ankues/grupit të mjekëve mikrobiologë, pranë NJVKSH-ve, mbajtën të njëjtin qëndrim si ai i komunikuar shkresërisht me KMD-në.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 480/6 prot., datë 10.07.2024, Komisioneri iu drejtua Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me marrjen e informacionit, sa i përket:
- *Hapave të ndërmarrë nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin nr. 677, datë 13.11.2023.*
 - *A ka ndonjë propozim aktual nga Grupi i Punës lidhur me kërkesat e mjekëve të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor? Nëse po, të vihet në dispozicion të Komisionerit informacioni i kërkuar mësipër.*

Në përgjigje të sa më sipër, MSHMS, nëpërmjet shkresës⁷ nr. 2754/1 prot., datë 09.07.2024, informoi KMD-në se:

“Të gjitha rekomandimet e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 677, datë 13.11.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e sistemit të pagave në sistemin shëndetësor”, janë reflektuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

Gjithashtu, me shkresën⁸ nr. 1759/3 prot., datë 26.07.2024, MSHMS informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 26.6.2024, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera*

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 480/7 prot., datë 11.07.2024.

⁸ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 480/8 prot., datë 31.07.2024.

financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, lidhja nr. 4 “Vlerat e elementit “pagë për pozicion”, për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi”, Kreu V “Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor”, pika 3 “Mjek me specialitet që punojnë në shërbimet e shëndetit publik”, paga e mjekëve specialist epidemiologë dhe mjekëve specialist të tjerë, në shërbimin e epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor është barazuar me pagën e mjekut me specialitet në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor”. Nga këqyrja e VKM-së sipërcituar, konstatohet se në nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi, Kreu V “Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor”, pika 3 “Mjek me specialitet që punojnë në shërbimet e shëndetit publik”, i korrespondon pagës së mjekëve specialist epidemiologë dhe mjekëve specialist të tjerë, në shërbimin e epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor që punojnë në shërbimet e shëndetit publik, pra, kategorisë ku përfshihen edhe subjektet ankues.

6. Fakti i mësipërm, i është bërë i njohur subjekteve ankues nëpërmjet e-mailit datë 01.08.2024, nga ana e inspektorit të çështjes, duke i bashkëlidhur edhe aktet përkatëse shkresore të sipërcituara.
7. Në vijim të sa më sipër, një nga përfaqësueset e subjekteve ankues/mjekëve epidemiologë pranë NJVKSH-ve, nëpërmjet e-mailit datë 08.08.2024⁹, ka falënderuar Komisionerin për angazhimin e tij dhe punën e bërë për trajtimin e çështjes së tyre, duke cituar ndër të tjera se: “...Duke ju falënderuar për mbështetjen ju bëjmë me dije se mjekët epidemiologë të NJVKSH Tiranë, përfituan rritjen e pagës sipas VKM Nr. 424, datë 26.06.2024”. Gjithashtu, mjekja A. M., informoi Komisionerin nëpërmjet e-mailit datë 08.08.2024, ndër të tjera se: “...Në lidhje me kërkesën tonë pranë institucionit tuaj për vlerësimin e pagës sonë si gjithë mjekët e tjerë specialist ju informoj që është realizuar në bazë të VKM-në nr. 424, datë 26.06.2024, në NJVKSh Fier. Ankesa jonë ka marrë zgjidhje falë punës së Zyrës tuaj e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Referuar analizës së bërë VKM-së nr. 764, datë 28.12.2023, u evidentua se mjekët/subjektet ankues me specialitet në epidemiologji, të cilët janë emëruar nga Ministria e Shëndetësisë pranë NJVKSH-ve, nuk ishin të përfshirë në asnjë nga strukturat dhe nivelet e pagave të parashikuara në këtë Vendim, krahasuar me mjek specialist të tjerë sikurse mjekët mikrobiolog, duke u vënë kështu në pozita të pabarabarta mes tyre. Megjithatë, pas analizimit të situatës nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 677, datë 13.11.2023, të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e sistemit të pagave në sistemin shëndetësor”, janë konstatuar dhe reflektuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424, datë 26.06.2024, ndryshimet përkatëse, duke përfshirë në të si pëfitues, të gjithë mjekët e licencuar si mjek me specialitet. Në këto kushte, si pëfitues të ndryshimeve të bëra, ishin dhe mjekët epidemiolog, duke i vënë në të njëjtat pozita të barabarta me mjekët e tjerë, si ata higjenist, mikrobiolog etj.

⁹ Depozituar në dosjen e subjekteve ankues, në cilësi prove.

Sa më sipër, referuar nenit 2, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, qëllimi i tij, është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Sakaq, Komisioneri vëren se synimi apo qëllimi i ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në rastin konkret është vendosur nga ana e Këshillit të Ministrave, duke vënë në kushte të barabarta subjektet ankues/mjekët epidemiolog me mjekët e tjerë të NJVKSH-ve.

Nga informacioni i administruar por edhe nga analiza e bërë VKM-së Nr. 424, datë 26.06.2024, konstatohet se mjekët specialist epidemiologë dhe mjekët specialist të tjerë, në shërbimin e epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor që punojnë në shërbimet e shëndetit publik, ku përfshihen edhe subjektet ankues, kanë përfituar rritjen e pagës si të gjithë mjekët e tjerë të NJVKSH-ve, duke plotësuar qëllimin dhe kërkesën për të cilën kishin paraqitur ankesën pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe në informacionin e administruar por edhe nga analiza e bërë VKM-së Nr. 424, datë 26.06.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 62 regj., datë 28.03.2024, të paraqitur nga subjektet ankues/grupi i mjekëve epidemiologë pranë NJVKSH-ve, kundër Këshillit të Ministrave, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik dhe qëllimi si dhe kërkesa për të cilën ishte paraqitur ankesa pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është plotësuar.

- Lidhur me kërkesën tjetër të palës ankuese për *dëmshpërblim sipas vlerës së mohuar nga paga që i ka takuar Mjekut Specialist të NJVKSH-ve*, Komisioneri, bazuar në kompetencat

që i atribuon LMD, nuk ka tagër për të dhënë dëshmipërblim (edhe nëse konstaton diskriminim).

Komisioneri thekson se, neni 34, pika 1, e LMD-së, parashikon se: *“Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmipërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale”*.

Neni 37, pika 1 e këtij Ligji, përcakton se: *“Vendimi i Gjykatës cakton dëshmipërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”*.

Po kështu, neni 38, i po këtij Ligji, përcakton se: *“Dëshmipërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”*.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 62 Regj., datë 28.03.2024, të grupit të personave/mjekë epidemiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), kundër Këshillit të Ministrave, për shkak se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë)

(Fusha: Punësim)